



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:129266

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05852494

Ac.nr.1779/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K.S. me seli në Prishtinë, rr. “L. e P.”, Magjistralja Prishtinë – Fushë Kosovë, kundër të A. A. J. nga fsh.P. – Komuna e Gjilanit, objekti i kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.517/17, i datës 15.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses B.K.S., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.517/17, datë 15.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.517/17, i datës 15.12.2020, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.K.S. me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri A. A. J. që ta përmbushin ndaj paditëses obligimin në shumën prej 13,337.00 € në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 04.11.2011 në Gjilan, edhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës të cilat do ti caktoj kjo gjykatë në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Sipas pretendimeve ankimore në të cilat kryesisht fokusohen pretendimet ankimore, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar ligjin material kur ka arritur në përfundim se kërkesëpadia është e parashkruar.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala e paditur ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse përmes të autorizuarit të tij me datë 24.07.2017 ka paraqitur padi për regresimin e dëmit, të cilin e kishte kompensuar ndaj palës së dëmtuar. Po ashtu rezultoi se sipas përshkimit në padi, aksidenti kishte ndodhur me datë 04.11.2011 në Gjilan, deri tek aksidenti kishte ndodhur kur automjeti "A" të cilin e drejtonte i padituri nga pakujdesia i shkakton dëme të dëmtuarit E. B.. Automjeti i cili ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit ka qenë pa mbulesë sigurorese. Palës së dëmtuar paditësja i kishte kompensuar dëmin ndërsa asaj i lind e drejta e regresit për të.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditëses.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar përsa i përket nxjerrjes së aktgjykimit jashtë seance, duke arsyetuar se pas pranimit të përgjigjes në padi nga i padituri, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë. Ka arsyetuar se i padituri përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar kërkesën mbi bazë të parashkrimit, ka propozuar që ajo të refuzohet e pa pabazuar. Më tej ka arsyetuar se me dispozitën e nenit 357 par.1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077 i vitit 2012) për kërkesat e natyrës së tillë është paraparë afati i parashkrimit prej tri vitesh, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë kjo padi është ngritur me dt. 24.07.2017, kurse data e nënshkrimit të ujdisë jashtëgjyqësore është arritur me dt.08.04.2014, çka do të thotë se në rastin konkret kanë kaluar mbi 3 vite kur paditësi është dashur t'a paraqes padinë, andaj duke u bazuar në rrethanat e këtij rasti dhe në dispozitën e lartcekur.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata e shkallës së dytë kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare. Po ashtu nuk ka pasur pretendim ankimor për sa i përket nxjerrjes së aktgjykimit jashtë seance.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse. Gjykata përmes provave të siguruara nga pala paditëse, në këtë rast marrëveshja e arritur jashtëgjyqësore me datë 08.04.2014 ndërmjet paditëses dhe të dëmtuarit në aksident, ka vërtetuar faktin e lidhjen se marrëveshjes, kurse përmes urdhërtransferit të datës 16.04.2014, është vërtetuar se i njëjti transaksion ka ndodhur po me të datë. Nga analizimi i thënieve në ankesë, për pjesën që ka të bëjë me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që sipas paraqitësit të ankesës, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keqinterpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një provë e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë kualifikimin në harmoni me të drejtën materiale. Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka interpretuar të njëjtën. Kjo gjykatë gjen se sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.29/78 (LMD) gjegjësisht neni 376 par. 1 *“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin.”* Kurse sipas nenit 360 par. 1 dhe 2 të njëjtit ligj *“Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes se detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.”* Gjykata vë në dukje se paditësja ka marrë njohuri dhe ka mundur të kërkojë të drejtën e tij për kompensim dëmi nga data 16.04.2014, ngase me këtë datë është dhënë urdhërtransferi i mjeteve tek pala e dëmtuar, kjo u dëshmuar përmes transferit të datës 16.04.2014, të cilin e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, pra nga kjo ditë paditëses i ka lindur e drejta për të kërkuar regresimin e mjeteve nga i padituri. Kjo gjykatë duke vlerësuar prapësimin e të paditurit lidhur me parashkrimin, dhe për këtë gjykata vëren nenin 360 të LMD-së, sipas të cilit *Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë.* Kurse pretendim kryesor i të paditurit ka qenë se kërkesa nga padia është përfshirë në parashkrim.

Kolegji vlerësoi se paditësja në gjykatë parashtron padi me datë 24.07.2017, pra pas kalimit të afatit tre vjeçar. Sipas nenit 361 të LMD-së *Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*. Gjkata vlerëson se paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit nga e paditura duke filluar nga data 16.04.2014, ngase më këtë ajo ka fituar cilësinë e kreditores, kurse paraqet padi në gjykatë pas kalimit të afatit tre vjeçar të parashkrimit. Neni 388 i LMD-së rregullon “[...] *Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës [...]*”. Sipas këtij përkufizimi ligjor, kreditori duhet të ndërmarrë veprime në drejtim të *debitorit*, në mënyrë që të ndërpritet parashkrimi. Në procedurë gjyqësore nuk është prezantuar asnjë provë apo fakt, i cili do të kishte rëndësinë vendimtare të ndërprerjes së afatit të parashkrimit ndaj të paditurit, që rrjedhimisht do të përbënte shkak që koha e kaluar e parashkrimit të mos llogaritet, dhe që parashkrimi të fillonte nga fillimi. Së këndejmi, në këtë rast kemi të bëjmë me afat 3 vjeçar të parashkrimit, ngase ky afat llogaritet nga momenti i transferit të mjeteve tek pala e dëmtuar. Përkitazi me vlerësimin e këtyre rrethanave, gjykata ka vlerësuar se paditësja ka humbur mundësinë që realizimin e kërkesës për kompensimin e dëmit ta realizoj në rrugë gjyqësore.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.1779/2021, datë 13.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli